



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Seancë plenare e Kuvendit të Kosovës

P- 009

Prishtinë, më 12 mars 2008, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
12 MARS 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 87 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në bazë të vendimit të Kuvendit për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe Legjislacionin e ndërlidhur me të, datë 15 shkurt 2008, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi njëzëri miratoi këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi i parë i grupit të dytë të projektligjeve nga Propozimi i Marti Ahtissarit:

- 1.1 Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
- 1.2 Projektligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës,
- 1.3 Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës,
- 1.4 Projektligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës,

- 1.5 Projektligji për të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre,
- 1.6 Projektligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë të vitit 2008,
- 1.7 Projektligji për financat e pushtetit lokal,
- 1.8 Projektligji për Aviacionin Civil të Kosovës,
- 1.9 Projektligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe
- 1.10 Projektligji për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligj iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari ftoi Kryeministrin, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se qëllimi i këtij projektligji është që të rregullojë autoritetin dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës së pavarur për ushtrimin e marrëdhënieve me shtetet dhe subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, promovimin e interesave politike dhe ekonomike të Kosovës, mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës jashtë shtetit, si dhe zhvillimin e raporteve me shtetet e tjera.

Ky projektligj rregullon përgjegjësitë dhe kompetencat e Qeverisë dhe të Presidentit të Republikës së Kosovës në zbatimin e politikës së jashtme.

Projektligji rregullon themelimin e një institucioni të ri, në kuadër të Qeverisë: Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës. Me të përcaktohet krijimi dhe organizimi i Shërbimit Diplomatik, i përbërë nga anëtarët e përhershëm të Ministrisë, si dhe anëtarët e Ministrisë së caktuar në Misione Diplomatike në vende të tjera dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Projektligji është në harmoni të plotë me dispozitat e Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me parimet e përgjithshme të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike (1961) dhe të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore (1963).

Kryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratojnë Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, në parim.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e mbështet Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ai kërkoi që dispozitat e këtij projektligji të harmonizohet logjikisht dhe gjuhësisht në të tri gjuhët.

Eqrem Kryeziu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se mbështesin Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të gjitha projektligjet që vijnë nga Pakoja e Ahtisarit..

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deklaroi se mbështesin, në parim, grupin e dytë të projektligjeve që burojnë nga Propozimi i Ahtisarit, për t'u proceduar në Komisionin ad-hoc.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështesin Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe projektligjet e tjera nga grupi i dytë që burojnë nga Propozimi i Ahtisaarit.

Lilzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështesin Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme. U japim mbështetje parimore edhe të gjitha projektligjeve, të cilat janë proceduar për seancën e sotme.

Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar "7+", tha se e mbështet Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----87,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës

Kryetari e ftoi Kryeministrin, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se Qeveria, në bazë të nenit 5.1 të Aneksit 8 të Propozimit të Presidentit Ahtisari, të dispozitave të Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me qëllim të themelimit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ka hartuar Projektligjin për Ministrinë e Forcës së Sigurisë.

Në bazë të këtij projektligji, Ministria do ta mbikëqyrë dhe ushtrojë kontrollin civil mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ministria ka kontroll dhe administrim të përgjithshëm mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke përfshirë të gjitha fuqitë që bien mbi komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji mbështetet në themelimin e një ministrie, e cila do të funksionojë në pajtim me parimet demokratike, me një staf profesional shërbyes civil, me përvojë dhe pjesëtarë - shërbyes të Forcës së Sigurisë së Kosovës - e ngjashme me ato të shteteve, anëtare të NATO-s.

Kryetarët e grupeve parlamentare më parë ishin deklaruar se i mbështesin, në parim, të gjitha projektligjet e grupit të dytë nga Propozimi i Marti Ahtisaarit.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----90,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Forcën e Sigurisë së Republikës të Kosovës

Kryetari ftoi Kryeministrin, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se Qeveria, në bazë të nenit 5.1 të Aneksit 8 të Propozimit të Presidentit Ahtisari, të nenin 126 të Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me qëllim të themelimit të Forcës së Sigurisë të Republikës së Kosovës, ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për miratim Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Republikës të Kosovës.

Me këtë projektligj rregullohet themelimi i Forcës së re të Sigurisë së Kosovës, me përbërje profesionale dhe multietnike, si dhe organizimi i brendshëm i saj.

Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës është të shërbejë si forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, në bashkërendim të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare.

Forca e Sigurisë do të jetë e armatosur sipas standardeve ndërkombëtare. Kjo forcë do të përbëhet nga 2.500 pjesëtarë aktivë dhe 800 pjesëtarë rezervë.

Ajo do të jetë e dizajnuar dhe e përgatitur për t'i përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë apo organizatave të tjera për zbatimin e ligjit.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij pprojektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----95,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi Kryeministrin, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se Qeveria, në bazë të nenit 1.4 të Aneksit 8 të Propozimit të Presidentit Ahtisari, të nenin 127 të Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me qëllim të themelimit të Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës, ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për miratim Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Republikës të Kosovës.

Projektligji përcakton: themelimin, përbërjen, kompetencat dhe fushëveprimtarinë e Këshillit të Sigurisë së Kosovës gjatë gjendjes së zakonshme dhe periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme.

Me këtë projektligj themelohet një strukturë e re e sigurisë - Këshilli i Sigurisë së Republikës të Kosovës - i cili do të funksionojë si një organ këshillues gjatë periudhës së zakonshme dhe si një organ ekzekutiv gjatë situatave të gjendjes së jashtëzakonshme.

Këshilli rekomandon politika dhe strategji për siguri. Misioni dhe fushëveprimtaria e tij mbështetet në ofrimin e informatave dhe të vlerësimeve për gjendjen e sigurisë në Kosovë, që t'i mundësojë Qeverisë të marrë vendime përkatëse lidhur me çështjen e sigurisë.

Deputeti **Xhezair Murati** propozoi që në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Republikës të Kosovës të jetë edhe një përfaqësues i komuniteteve joshumicë.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij pprojektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----89,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për themelimin e Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqes raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Kryetari ftoi Kryeministrin, që në emër të Qeverisë, ta prezantojë Projektligjin.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se Qeveria, me qëllim të rregullimit të autoritetit dhe të kompetencave të institucioneve të Kosovës, ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për miratim Projektligjin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Me këtë projektligj komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që lirisht të kultivojnë, të shprehin dhe të zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre, të përdorin gjuhën e tyre, të drejtë që ta mbrojnë veten në gjyq në gjuhën e tyre, të drejtën e themelimit të shoqatave kulturore, artistike, shkencore dhe arsimore, të drejtë që të festojnë festat e tyre tradicionale dhe fetare, të drejtën e informimit në gjuhën e tyre nëpërmjet gazetave ditore, mediave elektronike, agjencive të lajmeve, të drejtën në shkollim publik në të gjitha nivelet në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës, që ata e zgjedhin, të drejtë në shkollim

publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre, të drejtë në lirinë e besimit, të ndërgjegjes dhe të fesë, si dhe të drejtat e tjera të përcaktuara në dispozitat e këtij Projektligji.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligjit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----89,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë të vitit 2008

Kryetari ftoi ministrin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se Ligji aktual për menaxhimin e financave publike ka siguruar bazën ligjore për menaxhimin e fondeve publike. Por me zhvillimin e proceseve në Kosovë, është e nevojshme që ai të ndryshohet dhe të plotësohet për t’iu përshtatur ndryshimeve në vend, që parashihen me Propozimin e Ahtisarit.

Në vazhdim, ministri Shala shpjegoi ndryshimet që janë bërë me këtë projektligj krahasuar me atë të mëparshmin, siç janë : neni 49 përcakton huazimet dhe i mundëson Qeverisë së Kosovës të hyjë në marrëveshje për huazime dhe të nxjerrë garanci për borxhe; neni 54 parasheh që në kuadër të Ministrisë së Financave të jetë Njësia për Partneritet Privat Publik dhe neni 57 parasheh zbatimin dhe harmonizimin e tij me Ligjin për financat e qeverive lokale.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligjit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----91,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financat e pushtetit lokal

Kryetari ftoi ministrin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se Projektligji për financat e pushtetit lokal është i një rëndësie të veçantë për decentralizmin fiskal në Kosovë.

Ky projektligj përcakton një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse, sidomos në autorizimet e shtuara në rregullimin autonom dhe menaxhimin e resurseve financiare, që dalin nga Propozimi i Ahtisarit.

Ky projektligj plotëson kërkesat kryesore, si në vijim:

- merr masa të përshtatshme të barazimit për komunat më të vogla me kapacitete të ulëta për të hyra vetjake;
- bënë alokimin adekuat të resurseve për komunitetet jo shumicë;
- bënë sigurimin e financimit për kompetencat e shtuara komunale në komunat e caktuara si dhe qasjen në asistencën financiare të jashtme, në veçanti nga Republika e Serbisë.

Në vazhdim, ministri Shala shpjegoi dispozitat e Projektligjit, me të cilat rregullon grantet dhe huazimet e komunave.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligjit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----81,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për financat e pushtetit lokal.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Aviacionin Civil të Kosovës

Kryetari e ftoj ministrin Fatmir Lima, që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Transportit dhe i Postë-Telekomunikacionit, **Fatmir Lima**, tha se Aviacioni Civil në Kosovë ka qenë i rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/18 dhe me atë 2004/5, sipas të cilave kompetencat në këtë fushë kanë qenë nën autoritetin e UNMIK-ut. Me këtë projektligj këto kompetenca barten plotësisht në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj Kosova ka sovranitet të plotë, ekskluziv dhe të paprekshëm në hapësirën e saj ajrore dhe ka autoritet ekskluziv për organizimin dhe rregullimin e aktiviteteve të aviacionit civil në territorin dhe në hapësirën ajrore të vendit tonë.

Autoriteti i Aviacionit Civil definohet si autoritet kryesor kombëtar i rregullimit të aspektit të sigurisë teknike, përfshirë këtu edhe rregullimin e sigurisë, të ekonomisë së aeroporteve, certifikimin e personave, të operatorëve ajrorë të fluturakeve dhe të personelit ajror.

Projektligji rregullon dhe krijon mundësi të mjaftueshme për zhvillimin, menaxhimin, operimin, mbikëqyrjen e fushës së aviacionit nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligjit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----96,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se, Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Aviacionin Civil të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi ministren Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se nevoja për nxjerrjen e Ligjit për Prokurorinë Speciale është përshpejtimi i procedurave për ndjekjen dhe hetimin e veprave penale për krimet e luftës, krimet e organizuara, terrorizmin, krimet ekonomike e financiare dhe krimet e tjera serioze.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore për themelimin e Prokurorisë Speciale, si institucion i pavarur i Republikës së Kosovës, me prani të përkohshme të prokurorëve të EULEX-it.

Në vazhdim ministrja Kelmendi shpjegoi strukturën e këtij projektligji, të normuar në pesë kapituj dhe 16 nene, që përmban: dispozitat e përgjithshme, kompetencat e veçanta të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, delegimin e lëndëve, si dhe dispozita përfundimtare dhe kalimtare.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligjit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----85,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 5.

Kryetari konstatoi se, Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Republikën e Kosovës

Kryetari ftoi ministren Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji buron nga Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, dhe ai përcakton përfshirjen e një numri të caktuar gjyqtarësh dhe prokurorësh të EULEX-it, të cilët do të bashkëpunojnë ngushtë me gjyqtarë dhe prokurorë vendorë.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore për Misionin e EULEX-it në Kosovë dhe ofrimin e ndihmës për forcimin e sistemit gjyqësor dhe të atij prokurorial në Kosovë.

Në vazhdim, ministrja Kelmendi shpjegoi strukturën e këtij projektligji, të radhitur në katër kapituj dhe 19 nene, siç janë: dispozitat e përgjithshme dhe përkufizimet, kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në çështjet penale e civile, kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it, si dhe dispozitat përfundimtare e kalimtare.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligjit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----83,

Kundër----- 6,

Abstenime----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Republikën e Kosovës,

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale